



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 926/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Muhamet Rexha kryesues, Ymer Hoxha dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi me Adriana Hodziq kandidate për kryetare të komunës së Mitrovicës së Veriut, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) lidhur me mospërputhjet e rezultateve nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Adriana Hodziq kandidate për kryetare të komunës së Mitrovicës së Veriut,

**Arsyetim**

PZAP-i, me datën 15.11.2013 ka pranuar një ankesë nga Adriana Hodziq kandidate për kryetare të komunës së Mitrovicës së Veriut, ne të cilën thekson se në disa Qendra të Votimit në komunën e Mitrovicës së Veriut ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave.

Sipas parashtresës së ankesës në QV 3804/1, 3802b/01, 3801b/2 në Suhodoll, në QV 3802b/13802/2 në Lagjen e Boshnjakëve, dhe QV 3803b/1 Mikronaselje në Mitrovicë Janë bërë shkelje të ligjit dhe procedurave gjatë numërimit të votave si dhe vjedhja e 10 votave. Kjo bënë të dyshimtë rregullsinë e votave të numëruara dhe manipulimin e tyre.

Parashtresja e ankesës ka përmendur disa emra si dëshmitar të mundshëm si Vladimir Branoviq, Nusret Cerani, Nehat Aliu dhe Hamit Mripa dhe i ka propozuar PZAP-it që të bëhet rinumërimi i votave në këto QV në Mitrovicën e Veriut.

PZAP-i me datën 16.11.2013 ka kërkuar nga KQZ tërë materialin zgjedhor si Listën përfundimtare të votuesve, Formularët e Përputhjes së Rezultateve (FPR), Formularët e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) dhe Librin e Vërejtjeve, për këto qendra të votimit

lidhur me pa rregulluesit e pretenduara, andaj PZAP-i në bazë të nenit 117.2, 117.4 të LZP-së dhe nenit 12 i Rregullës së PZAP-it ka shqyrtuar dhe hetuar materialin zgjedhor dhe pretendimet ankimore, provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç e në lidhshmërinë si dhe duke u bazuar në rezultatin e tërësishëm të provave të administruara ka gjetur se:

### **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e pa bazuara pasi që në bazë të hetimit dhe shqyrtimit të materialit zgjedhore si dhe në bazë të pretendimeve ankimore nuk ka gjetur prova të besueshme që do ti vërtetonin pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, andaj një pretendim i tillë i është i pabazë dhe i pa argumentuar mirë në prova dhe në dëshmi bindëse, andaj duke u bazuar nenin 118.1 të LZP-së, e vendos si në dispozitivë të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 926/2013 më datën 18.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.